

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me sekretaren juridike Adelina Brestovci, në lëndën penale ndaj të pandehurit Z. A. nga Gj., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale , nga neni 320 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm(PTH-DP), PP.II.nr.966/16 e datës 14.06.2016 të cilën e përfaqësonte prokurori Shefik Mehmeti, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 29.12.2016, mori dhe shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri Z. A. nga babai R. dhe nëna F. e lindur S.,i lindur më ... ne fsh.B. e B. e tani jeton në Gj. , rruga “...” nr.pa nr., banesa e ... me qëra, i martuar,babë i pesë fëmijve, I pa punësuar ,i gjendjes së varfër ekonomike,shfrytzuës i skemës sociale, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës,nuk ka qenë i dënuar me parë për ndonjë vepër tjetër penale,

Është fajtor Sepse

Prej datës së pavërtetuar e deri me dt..., në kohë të papërcaktuar, në banesën e tij me qëra në Gj., në mënyrë të vazhdueshme dhe të paautorizuar,ka përfituar nga shërbimi komunal-rrjeti i shpërndarjes së rrymës së KEDS-it, në at mënyrë që është lidhur direkt pa njëisor elektrik nga shtylla, ka shpenzuar energji elektrike pa u regjistruar askund si shpenzim, me që rast KEDS-in Distrikti në Gjilan, e ka dëmtuar për shumën e të hollave në vlerë prej 96.77 Euro.

-me çka ka kryer vepëren penale vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj,gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,21, ,49, 50,51,52 e 73 të KPRK, si dhe nenit 365,451 e 451 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton :

DËNIM KUMULATIV ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit H. H., i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve si dhe dënim me gjobë në shumë prej 150 (njëqindpesëdhjetë) euro, të cilat dënime i pandehuri nuk do ta vuajë, gjegjësisht nuk do ta paguaj, nëse në afat prej 1 (një) viti, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

E dëmtuara KEDS udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore- juridike.

Kondorm nenit 453 par.4, të akuzuarin gjykata e liron nga shpenzimet procedurale, e të cilat bien në barrën bugetore të kësaj gjykate, pasi që i njëjti është shfrytëzues i ndihmës sociale me kartelën nr.31442 e kopja e të cilës gjendet në shresat e lëndës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.966/16 të datës 14.06.2016 ndaj të pandehurit Z. A. nga Gjilani, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale , nga neni 320 të KPRK-së

Prokurori i Shtetit Shefik Mehmeti në fjalën e tij përfundimtare, gjatë seancës fillestare të datës 29.12,2016, ka deklaruar: mbes në tërësi pranë aktit akuzues pasi që në shqyrtimin e sotëm fillestar I akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, për të cilën pranim gjykata e ka njoftuar me pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë.Mbi bazën e këtij pranimi dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj me dënim meritator sipas ligjit. I cili dënim do të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqerore të kësaj vepre penale.

I pandehuri Z. A. ka deklaruar : se është hera e parë që ndeshem me ligjin i premtoj gjykatës se një gjë të tillë nuk do ta përsërisë , dhe kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të butë .

Pas dëgjimit të Prokurorit të Shtetit dhe të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i pandehuri Z. A. nga Gj., me dashje e ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së

Gjyqtari i vetëm gjykues, e shpalli fajtor të pandehurin H. H., nga Gj. për veprën e cekur më lartë ngase veprimet e të njejtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj veprë penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit , gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73 të KPK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, është i gjendjes së varfër ekonomike, ka shprehur keqardhje për kryerjen e kësaj veprë, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht, ndaj të pandehurit Z. A. është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 50 të KPK.

Vendimi për kërkesën pasurore- juridike është marrur duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 ndërsa vendimi mbi lirimin e pagesës nga i akuzuari të shpenzimeve të procedurës penale, si dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 par.4 paragrafi 1 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i përgjithshëm

Më 29.12.2016

**Sekretarja juridike,
Adelina Brestovci**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ramiz Azizi**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.